



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 1561 prot.  
4

Tiranë më 07.11.2018

**VENDIM**

Nr. 60, datë 07.11.2018

**MBI**

**ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës*",

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr.261, datë 19.10.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 22.10.2018 grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit me objekt:

- Verifikim i zbatimit të Rekomandimit Nr. 61 datë 26.12.2017, Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "*Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Durrës*".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "*I.E.V.P. Durrës*", konstaton se:

1. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore "*Për mbrojtjen, përpunimin, dhe ruajtjen e të dhënave personale*", në zbatim të pikës së tretë të Rekomandimit Nr. 61/2017 të Komisionerit dhe nenit 27 të ligjit. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit

27 të Ligjit Nr.9887/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, pika 2/1: *"Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera."*

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe përdorimi i saj nga nëpunësit e tij, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe detyron punonjësit për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen nga keqpërdorimi dhe mënyrën e administrimit të të dhënave personale.

2. Kontrolluesi nuk ka marrë masa për *"ruajtjen e konfidencialitetit"* nga punëmarrësit të cilët, për shkak të detyrës dhe përkrahimit të pozicionit të punës, kanë akses në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të pikës së katërt të Rekomandimit Nr. 61/2017 të Komisionerit dhe nenit 28 të Ligjit. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*: *"Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj"*.
3. Kontrolluesi nuk ka njoftuar Zyrën e Komisionerit në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën e pestë të Rekomandimit Nr. 61/2017 të Komisionerit.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin (datë 22.10.2018), të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit e ka nënshkruar duke paraqitur komentin: *"Angazhohemi që të plotësojme detyrimet e lëna nga Komisioneri sa më shpejtë"*.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*, kontrolluesi *"I.E.V.P. Durrës"* është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi është paraqitur në seancë dhe ka dokumentuar rikuperimin e shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij.

Zyra e Komisionerit e vlerëson këtë qëndrim dhe reflektim të menjëhershëm, por kjo nuk e përjashton kontrolluesin nga përgjegjësia administrative. Shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar në vitin 2017 pranë kontrolluesit *"I.E.V.P. Durrës"*, duhej të rikuperoheshin brenda afatit 30 ditor dhe për masat e marra, duhej të njoftohej me shkrim Zyra e Komisionerit, sipas pikës së pestë të Rekomandimit Nr. 61/2017.

Si përfundim shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në lidhje me mungesën e rregullores specifike *"Për mbrojtjen, përpunimin, dhe ruajtjen e të dhënave personale"*, në kuptim të nenit 39, pika 1, gërma *"dh"* të Ligjit Nr.9887/2008 *"Për"*

*Mbrojtjen e të Dhënave Personale*". përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

*"Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10000 deri në 150000 lekë"*

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parashysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 27, 29, 30, 39 pika 1, gërma "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*",

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit "*I.E.V.P. Durrës*", me gjobë në vlerën 30.000 (tridhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
3. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 07.11.2018.

